



Agjencia e Punësimit (AP) në suaza të projektit ekzistues të financuar nga BE-ja “Mbështetja për punësimin e të rinjve, të papunëve afatgjatë dhe grave” (II), bën:

Shpallje publike

për personat e papunë afatgjatë për pjesëmarrje në “Stërvitjen për plotësimin e nevojave në profesionet e kërkuara në tregun e punës”

U bëhet thirrje të gjitha të papunëve afatgjatë të evidentuar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës, që të tregojnë interesim dhe të apalikojnë për marrjen e aftësive plotësuese dhe shkathtësive profesionale të cilat kërkohen në tregun e punës për profesionet siç vijonë:

. Montues dhe instalues i paneleve diellore

Stërvitjet do të mbahen në një periudhë prej katër muajsh. Ato përfshijnë ligjërata, orë përgatitëse për provime, si dhe për marrjen e certifikatës.

Secili person i papunë që do të zgjidhet për të marrë pjesë në stërvitje, do të nënshkruajë edhe marrëveshje për pjesëmarrje në këtë stërvitje.

Shpenzimet për pagesën mujore të pjesëmarrësve në stërvitje në shumën prej 6248,00 denarë, duke përfshirë edhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe tatimin personal për të ardhurat për secilin pjesëmarrës, do të mbulohen nga ana e Agjencisë së Punësimit në suaza të projektit aktual të financuar nga BE-ja “Mbështetja e punësimit të të rinjve, të papunëve afatgjatë dhe grave” (II).

Pas mbarimit të stërvitjes, secili nga pjesëmarrësit të cilët e plotësojnë kushtin për minimum 70 për qind pjesëmarrje të orëve të parapara për stërvitje dhe që kanë marrë vërtetim për realizimin e stërvitjes praktike, nuk mund të japin provim për verifikimin dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive të fituara para komisionit, dhe as të marrin certifikatë.

Kriteret e aplikimit:

Personat e papunë afatgjatë të cilët janë të interesuar, mund të plotësojnë aplikacionin e nevojshëm, me qëllim që të marrin pjesë në stërvitjet e sipërtheksuar të Agjencisë së Punësimit në ndonjërin nga qendrat e saj brenda shtetit.

Secili kandidat duhet t'i plotësojë kriteret siç vijojnë:





- Personat e papunë afatgjatë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës më tepër se një vit;
- Personi i papunë në planin individual të punësimit (PIP) të ketë deklaruar se dëshiron t'i ndjekë stërvitjet për aftësitë e kërkuara në tregun e punës;
- Arsimit adekuat relevant për llojin e stërvitjes.

Përzgjedhja përfundimtare e pjesëmarrësve do të bëhet nga ana e komisionit të evaluimit në bazë të kriterëve të lartpërmendura, duke formuar listën ranguese të kandidatëve të interesuar.

Kandidatët të cilët deri tani nuk kanë marrë pjesë në stërvitje të këtilla, inkurajohen që të paraqiten për pjesëmarrje. Agjencia e Punësimit i inkurajon të gjithë personat e papunë afatgjatë të gjinive, nacionaliteteve dhe kulturave të ndryshme që të aplikojnë, me qëllim që të marrin aftësi relevante për aftësi specifike profesionale të kërkuara në tregun e punës. Personat e grupeve të pakicës, si dhe personat me nevoja të posaçme inkurajohen që të marrin pjesë,

Procedura dhe afati i aplikimit

Personat e papunë afatgjatë të cilët janë të interesuar dhe që janë të regjistruar si kërkues aktiv të punës, mund të dorëzojnë aplikacion për pjesëmarrje në Agjencinë e Punësimit dhe në ndonjërin nga 30 qendrat e saj brenda shtetit, duke shprehur interesimin e tyre për pjesëmarrje në stërvitjet për aftësitë e kërkuara në tregun e punës, duke theksuar tipin e stërvitjes, secilën ditë prej orës 8:30 deri 16:30.

Të gjitha të dhënat e përfshira në aplikacion do të konsiderohen sekrete.

Informata të hollësishme mund të merren në klubet e 30 qendrave të punësimit ku personat janë të evidentuar si të papunë, si dhe me anë të telefonit kontaktues (02) 3 213 070 dhe ueb faqen e Agjencisë së Punësimit www.avrm.gov.mk.

Shpallja publike do të botohet në ueb faqet siç vijojnë:

- Agjencia e Punësimit www.avrm.gov.mk
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale eëë.mtsp.gov.mk.

Projekti “Mbështetja për punësimin e të rinjve, të papunëve afatgjatë dhe grave” (II) është financuar në suaza të programit operativ për “Zhvillimin e burimeve njerëzore 2007-2013) (IPA Komponenti IV). Aktivitetet e projektit ndihmojnë drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve nga plani operativ i masave aktive në tregun e punës për vitin 2015.

